



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4079/1 Prot

Elbasan më 22/07/2026

VENDIM

Nr 92 datë 22/07/2026.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin QERSHOR 2026

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 22/07/2026

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin QERSHOR 2026, 73 familje me fond 214.820 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Miratoi: Dr Përgjithshëm
Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar
Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

M.Duka
D.Shuli
E.Arapi
A.Merkja
K.Krasnika

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar me _____ vota

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

4079/2
24.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 830/1 Prot

Elbasan, më 24.7.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.92, datë 22.07.2026 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin Qershor 2026”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Hir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4080/11 Prot

Elbasan më 22 /07/ 2026

VENDIM

Nr. 93 datë 22 /07/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi ikushtëzuar për muajin Qershor 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 22 /07/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Social

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **QERSHOR 2026** për 246 familje me një fond prej **1.152.571** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Pranoi : Dr Përgjithshëm
Drejt Dr Juridike
Drejt Dr Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar
Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Miratuar me _____vota

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

M.Duka
D.Shuli
E.Arapi
A.Merkja
K.Krasnika

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

4080/2

24.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 7311 Prot
1

Elbasan, më 24. 7.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.93, datë 22.07.2026 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2026", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





732
22.07-2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4082/1 Prot.

Elbasan, më: 22.07.2026.

V E N D I M

Nr. 94 Datë: 22.07.2026.

“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr. 7/40, ndodhur në Z.K. 8525, Lagja “Haxhias”, nga “Lulishte” në “Rrugë”, Bashkia Elbasan”.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .07.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse:

V E N D O S I :

1. Miratimin për fillimin e procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr. 7/40, ndodhur në Z.K. 8525, Lagja “Haxhias”, nga “Lulishte” në “Rrugë”, Bashkia Elbasan, duke qënë se pasuria në fjalë shërben realisht si rrugë kalimi e cila siguron aksesin e banorëve drejt banesave të tyre.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala



SEKRETARI
Elsid Zyma

Miratur me _____ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë ____/____/2026

4082/2
29.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 232/prot.

Elbasan, më 29.7.2026

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", përpara se të shprehemi për ligjshmërinë e aktit tuaj nr.94 dt.22.07.2025 "Për miratimin e fi llimit të procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr.7/40 në ZK 8525, Lagjja "Haxhias", nga "Iulishte" në "rrugë", Bashkia Elbasan", ju bëjmë me dije se lidhur me këtë vendim tuajin, ka paraqitur një ankesë-kërkesë z. Anesti Tore, banues në lagjen "Haxhias", pronar i pasurisë nr. 9/280, që ndodhet pranë pasurisë objekt i vendimit tuaj.

Në kërkesën e tij z.Tore, pretendon se ndryshimi i zërit kadastral të pasurisë 7/40 në ZK 8525 nga "Iulishte" në "rrugë", do të cënonte të drejtën e banorëve të zonës për të patur hapësira publike, do të përbënte rrezik të shtuar për fëmijët si dhe do të sillte një situatë kaotike në zonë duke qenë dhe spitali rajonal pranë.

Sa më sipër, përpara se shprehemi për aktin në fjalë, kërkojmë të na informoni nëse gjatë vendimmarrjes janë marrë në shqyrtim pretendimet e z. Tore dhe çfarë keni konkluduar për rastin në fjalë. Bashkëngjitur një kopje e kërkesës së z.Tore.

Deri në dërgimin e të dhënave akti juaj mbetet i pakonfirmuar.



KËRKESË

Kërkuesi:

Anesti Tore, i biri Spiro dhe Kalije-s, i dtl. 08.04.1966, lindur ne Durres dhe banues ne Rajonin nr.5, lagja "Haxhias", Rr. "Abdurrahim Zaimi", Nd.1, Bashkia Elbasan.

Objekt:

Marrjen e masave administrative-teknike për te vleresuar sigurine publike nga ndryshimi i zerit kadastral/destinacionit te prones shtet nga "lulishte" në "rruge per mjetet motorrike", në pasurinë e paluajtshem me nr.7/40, në zk. 8525 Bashkia Elbasan.

Drejtuar:

PREFEKTIT TE QARKUT ELBASAN

Të nderuar!

Unë kërkuesi Anesti Tore, jam pronar i pasurisë së paluajtshme me nr.9/280 e llojit ndertese 3 kate +1 kat nentoke me siperfaqe 237.2 m²+25 m² ..etj, e cila ndodhet ne zonen kadastrale 8525, ne adresen tek hyrja e Spitalit Rajonal "Xhaferr Kongoli" Elbasan, lagja "Haxhias" Bashkia Elbasan.

Ju bej me dijen, bazuar në aktet që janë në arkiven e Bashkisë Elbasan, per shkak te aktivitetit tregtar "Bar Kafe", se nga viti 1995 deri aktualisht, ka marre me qera hapësiren publike llojit "lulishte" me pronësi "shtet", me nr.7/40,(*akti provues bashkelidhur kesaj kerkese*), nga Bashkia Elbasan, e cila ndodhet perpara objekti/nderteses qe kam në pronësinë time, duke paguar të gjithë detyrimet vjetore, ndaj Bashkisë Elbasan.

Gjithashtu jam vene ne dijeni, se shtetasit Aqif Hoxha...etj, i cili eshte fqinje me mua paska iniciuar procedurë administrative, drejtuar Keshillit Bashkiak Elbasan per ndryshimin e zerit kadastral/destinacionit të prones "shtet" nga "lulishte" në "rruge per mjete", në pasurinë e paluajtshem me nr.7/40, ne zk. 8525 Bashkia Elbasan, sipas tij në funksion te aktiviteti tregtare qe ushtron ne pasurine e tij.

Ju bej me dijeni se shtetasi Aqif Hoxha si dhe te gjithë banore qe jetojne dhe ushtrojne aktivitetin tregtare ne ate zone, perdorim si vendkalim/rrugen, në funksion te aktivitetit tregtar dhe kane akses(hyrje, dalje) ne banesat që kemi ne pronesi, nepermjet rruges "Abdurrahim Zaimi", e cila i ploteson te gjitha kushtet teknike, urbanistike per mjetet dhe kembesoret te aksesit dhe afersise per tu lidhur me objektet dhe aktivitetin tregtar qe ushtrohet ne te dhe nuk perben rrezik per sigurine publike

Pra, shtetasi Aqif Hoxha ka akses/rruge kalimi per te shkuar tek banesa dhe aktiviteti tregtare qe ushtron me automjet, si dhe çdo mjetet tjeter me funksion publik(*ambulanca, zjarrefiksia, makina qe merr mbetja*), per banoret e zones.

Çdo vendimarrje për ndryshimin e zerit kadastral/destinacionit te prones shtet nga lulishte në "rruge per mjetet motorrike", në pasurinë e paluajtshme me nr.7/40, ne zk. 8525 Bashkia Elbasan, do te cenonte te drejten e banoreve te zones per te pasur hapësira publike rekreative, do te perbente rrezik te shtuar per femijet dhe banoret e zones nga automjetet qe do te levizin, si dhe do te sillte

Anesti Tore

saos ne zone, duke krijuar situatë konfliktuale, duke marre ne konsiderat qe
është zone me fluks levizje, per shkak te spitalit, aty pranë.
Rruga ne koncept duhet te shërbeje si mjet komunikimi/aksesi me funksion
publik, por kurresesi nuk duhet te plotesoje interesa/orekset e individeve
/shtetasve konkret, në dem te interesave publike, i cili prevalon ndaj interesit
privat.

Gjithashtu hapja e rruges ne vendin ku e kerkon shtetasi Aqif Hoxha..etj, është
kunder te gjitha kondicioneve urbanisitike si dhe burim rreziku per sigurine
publike si dhe duke mos u marre mendimi i banoreve te zones per kete ndryshim
urbanistik/ndryshimi i destinacionit duke prish lulishten dhe hapur rrugen per
automjetet.

Gjithashtu bej me dijeni se hapja e rruges ne vendin qe kerkon shtetasi Aqif
Hoxha...etj, është ne korsine e emergjencave spitalore, kjo gje është vlerësuar
edhe nga ekspertet te fushes prane prefektures Elbasan, te cilet kane shprehur
qendrimin e tyre teknik se hapja e rruges perben rrezik te shtuar per mjetet e
spitalit dhe banoret e zones.

Sa i perket vendimit gjyqësorë të gjykates administrative, sipas disponimit te
gjykates dhe faktit rezulton se vendimi është ekzekutuar, tenda është hequr, nuk
ekziston me ne fakt.

Gjithashtu rezulton se gjykata ne pjesen aryetuese dhe ne dispozitive e saj, nuk
ka percaktuar ne asnje moment qe te urdheroje/detyroje organin publik
kompetent per ndryshimit të zerit kadastral/destinacionit te prones shtet nga
"lulishte" në "rruge per mjetet motorrike", në pasurinë e paluajtshem me
nr.7/40, ne zk. 8525 Bashkia Elbasan apo hapjen e rruges.

Në këto kushte, bazuar në rrethana e sipërcituara dhe ligjin e aplikueshëm në
fuqi,

Kërkoj:

Pranimin e kërkesës.

Marrjen e masave administrative-teknike për të vlerësuar sigurinë publike nga
ndryshimi i zerit kadastral/destinacionit faktik të prones shtet nga "lulishte" në
"rruge për mjetet motorrike", në pasurinë e paluajtshme me nr.7/40, në zk. 8525
Bashkia Elbasan.

KËRKUESI
Anesti Tore

Anesti Tore

Elbasan, më; 22.07.2026

TEL: 0698995888

fe

4327/1

13.08.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 832 prot.Elbasan, më 13.8.2026Lënda: 3 Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u mor në shqyrtim ligjshmëria e aktit tuaj nr.94 dt.22.07.2026 "Për miratimin e fillimit të procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr.7/40 në ZK 8525, Lagja "Haxhias", nga "Iulishte" në "rrugë", Bashkia Elbasan", si dhe pasi u njohëm me shkresën e Bashkisë Elbasan nr.4327 prot. datë 30.07.2026 "Kthim përgjigje", ju sqarojmë si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë që kërkesa dhe problematikat e ngritura nga z.Tore, janë paraqitur pasi vendimi është miratuar nga këshilli bashkiak, për të cilin ai pretendon se: miratimi i vendimit për hapjen e një rruge për automjetesh (duke qenë para faktit që një rrugë e tillë ekziston në funksion të këtyre banesave Rruga "Abdurrahim Zaimi"), do të sillte një situatë kaotike në një zonë sensitive që ndodhet pranë spitalit rajonal, si duke patur pretendimin se për këtë vendim marrje nuk janë zhvilluar seanca dëgjimore me komunitetin, sugjerojmë që akti të rishqyrtohet edhe njëherë në mbledhjen e radhës të këshillit bashkiak duke u trajtuar dhe pretendimet e lartpërmendura.

Sa më sipër aktin tuaj e kthejmë për rishqyrtim në këshillin bashkiak.

PREFEKTI

Ilir **BEJTJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4327 / 2 Prot.

Elbasan, më: 18.08.2026.

Lënda: Kthim përgjigje.

Prefekti i Qarkut

ELBASAN

Në vijim të shkresës suaj me nr. 832/3 Prot., datë 13.08.2026, "Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj", Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

- Z.Anesti Tore ka depozituar pranë Bashkisë Elbasan shkresën nr.1722 Prot., datë 22.07.2026 "*Pezullim procedurash për Këshillin Bashkiak*" ku kërkon pezullim të procedurës së iniciuar nga ana e bashkisë Elbasan për pasurinë e saj nr.7/40 në zk.8525. Në lidhje me këtë kërkesë, Bashkia Elbasan i ka kthyer përgjigje z.Anesti Tore me shkresën nr.1722/1 Prot., datë 27.07.2026 "*Kthim përgjigje*".
- Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë 11.07.2007 "*Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit*", **pasuria me nr .7/40 ndodhur në zk.8525 është transferuar në pronësi të Bashkisë Elbasan.**Pra është pronë e Bashkisë Elbasan dhe duke qenë pronare e saj, ka të drejtën për disponimin, rikualifikim e përditësim të saj.
- Pranë Bashkisë Elbasan është depozituar shkresë "*Kërkesë e përsëritur për ekzekutim vendimi*" me nr.720 Prot, datë 01.07.2026 e Zyrës Përmbarimore Private TIRANA BAILIFF'S SHPK për zbatim të vendimit nr. 1415 (80-2025-1409) datë 25.04.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt "*Për lirimin dhe sitemimin e plotë të hapësirës publike pasuria nr.7/40 ,ZK 8525, Lagja "Haxhias" me emërtimin "Lulishte" në pronësi të Bashkisë Elbasan*".Duke qenë se kërkesa e zyrës përmbarimore është titull ekzekutiv, Bashkia ka vijuar procedurat për zbatimin e saj.
- Gjithashtu pranë Bashkisë Elbasan është depozituar dhe kërkesë e vetë banorëve të lagjes "Haxhias", me nr. 1529 Prot, datë 01.07.2026, me objekt "*Zbatim Vendimi dhe detyrimin e Bashkisë për rikthimin e kësaj hapësire në rrugë publike ,*". Referuar faktit që kemi kërkesën e vetë banorëve të zonës , për zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë , nuk është e nevojshme dhe e domosdoshme të kryhet procesi i dëgjësës publike me banorët .

Ndodhur në këto kushte Bashkia Elbasan ka konstatuar nevojën për rishikimin e funksionit të kësaj pasurie dhe ka nisur procedurën për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të

pasurisë nr.7/40, ndodhur në Z.K. 8525, nga "Lulishte" në "Rrugë" si titullare e kësaj pasurie për të cilën ka të drejtën disponueshmërisë.

Këshillit Bashkiak i është kërkuar miratimi për ndryshim të zërit kadastral nga "Lulishte" në zërin "Rrugë".

Bashkëngjitur po ju ridërgojmë fletën e inventarit për pasurinë 7/40, shkresën e Tirana Bailiff's SHPK për zbatimin e vendimit gjyqësor, fotokopje të ankesës së banorëve të lagjes "Haxhias" si dhe shkresën kthim përgjigje të Bashkisë Elbasan drejtuar z.Anesti Tore.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

Konceptoi : A..Brateshi

Pranoi : G.Dyrmyshi

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika

KRYETARI
Gledian Llatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 2321 prot.

Elbasan, më 13.7.2026

B
Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u mor në shqyrtim ligjshmëria e aktit tuaj nr.94 dt.22.07.2026 "Për miratimin e fillimit të procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr.7/40 në ZK 8525, Lagjja "Haxhias", nga "lulishte" në "rrugë", Bashkia Elbasan", si dhe pasi u njohëm me shkresën e Bashkisë Elbasan-nr.4327-prot. datë 30.07.2026 "Kthim përgjigje", ju sqarojmë si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë që kërkesa dhe problematikat e ngritura nga z.Tore, janë paraqitur pasi vendimi është miratuar nga këshilli bashkiak, për të cilin ai pretendon se: miratimi i vendimit për hapjen e një rruge për automjetesh (duke qenë para faktit që një rrugë e tillë ekziston në funksion të këtyre banesave Rruga "Abdurrahim Zaimi"), do të sillte një situatë kaotike në një zonë sensitive që ndodhet pranë spitalit rajonal, si duke patur pretendimin se për këtë vendimmarrje nuk janë zhvilluar seanca dëgjimore me komunitetin, sugjerojmë që akti të rishqyrtohet edhe njëherë në mbledhjen e radhës të këshillit bashkiak duke u trajtuar dhe pretendimet e lartpërmendura.

Sa më sipër aktin tuaj e kthejmë për rishqyrtim në këshillin bashkiak.

PREFEKTI

Ilir **BEJTJA**

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

651	8525 I-8	Lulistet e Rrugën E Spitalit	Lulishte	Lagja "Haxhias"	17787.89	Gjelberim	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan	Numrat Kadastral 7/34. 7/35. 7/37. 7/40. 7/43. 7/44
-----	-------------	------------------------------	----------	-----------------	----------	-----------	-----------------	-----------------	--

Date 30.06.2026

KËRKESË

Drejtuar:

Z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan

Z. Lutfi Lala, Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

KËRKUESIT:

1. **Aqif Hoxha**, i biri i Sherif dhe Gjyle, lindur më 07.04.1962 në Qerret, Elbasan, i identifikuar me letërnjoftimin nr. G20407167C.
2. **Pëllumb Aça**, i biri i Xhevahir dhe Lirije, lindur më 17.03.1963 në Dibër, i identifikuar me letërnjoftimin nr. G30317082O.
3. **Rruzhdie Shguni**, e bija e Sali dhe Behije, lindur më 01.06.1966 në Elbasan, e identifikuar me letërnjoftimin nr. G65601009C.
4. **Ramazan Alla**, i biri i Amatit, lindur më 03.08.1961 në Elbasan, banues në Elbasan.
5. **Përparim Aça**, i biri i Xhevahir dhe Lirije, lindur në Muçinë, Dibër, i identifikuar me letërnjoftimin nr. G60725072Q, banues në Elbasan.

OBJEKTI: Kërkesë për zbatimin e Vendimit nr. 1415 (80-2025-1409), datë 25.04.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresës së IKMT nr. 2831/5 prot., datë 28.04.2026, si dhe vendimit të Zyrës së Përmbarimit Privat "Tirana Bailiff's" për ekzekutimin e detyrueshëm, për lirimin dhe sistemimin e plotë të hapësirës publike nr. 7/40, ZK 8525, Lagjja "Haxhias", Elbasan, si dhe detyrimin e Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak Elbasan për rikthimin e kësaj hapësire në rrugë publike me emërtimin dhe funksionin e saj sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe administrimin e territorit.

Të nderuar Zotërinj,

Ne, kërkesit e sipërcituar, banorë dhe pronarë të pasurive të paluajtshme në Lagjen "Haxhias", Elbasan, ju drejtohem sërish në lidhje me moszbatimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka urdhëruar shprehimisht lirimin dhe sistemimin e hapësirës publike me nr. pasurie 7/40, ZK 8525, e cila shërben si rrugë e vetme aksesit për pasuritë tona dhe për funksionimin normal të aktivitetit tonë ekonomik dhe jetësor.

Kjo hapësirë, e cila historikisht ka funksionuar si shesh dhe rrugë kalimi me gjerësi të konsiderueshme, ka shërbyer si pikë lidhëse ndërmjet pasurive tona dhe rrugëve kryesore të zonës. Para ndërtimit të murit rrethues të Spitalit Rajonal "Xhaferri Kongoli", kjo hapësirë ka funksionuar qartësisht si shesh publik i hapur dhe i aksesueshëm. Me ndërtimin e murit rrethues të spitalit, zëri kadastral ka vijuar të mbetet i regjistruar si "shesh" në dokumentacionin kadastral, megjithatë, në

realitetin faktik dhe funksional, hapësira është transformuar në një korridor kalimi, pasi ndodhet e kufizuar ndërmjet ndërtesave ekzistuese dhe murit rrethues të spitalit, duke marrë tiparet dhe funksionin e një rruge publike aksesit.

Pas prishjes së tendës për hijezim të ndërtuar nga Anesti Tore, vijojnë të mbeten bordura betoni dhe elementë të tjerë fizikë të fiksuar, duke mos e kthyer sipërfaqen në gjendjen e mëparshme. Kjo situatë ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta në cenimin e të drejtës së pronësisë dhe ushtrimit të aktivitetit ekonomik të banorëve, si dhe ka kufizuar ndjeshëm aksesin e mjeteve të emergjencës, si ambulanca, zjarrfikëse dhe policia, duke krijuar rrezik real për sigurinë publike.

Për këtë problematikë, ne kemi ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe institucionale, duke iu drejtuar Bashkisë Elbasan, institucioneve të inspektimit dhe organeve të drejtësisë, përfshirë Inspektoriatin Vendor dhe Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë Vendore të ASHK Elbasan. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur shfuqizimin e akteve dhe detyrimin e Bashkisë Elbasan për lirimimin dhe sistemimin e plotë të hapësirës në fjalë, vendim i cili ka marrë formë të prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

Në vijim të këtij vendimi, Zyra e Përmbartimit Privat "Tirana Bailiff's" ka nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, ndërsa Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka kërkuar marrjen e masave konkrete për heqjen e pengesave dhe kthimin e hapësirës në gjendjen e saj funksionale si rrugë publike. Pavarësisht këtyre akteve dhe vendimeve, në terren vijon të konstatohet prania e pengesave fizike, të cilat e bëjnë të pamundur qarkullimin normal të mjeteve dhe aksesin e plotë të qytetarëve.

Në këto kushte, dhe duke marrë parasysh se vendimi gjyqësor i formës së prerë është detyrues për zbatim nga të gjitha organet publike, çdo vonesë apo mosveprim në ekzekutimin e tij përbën shkelje të parimeve të shtetit të së drejtës dhe cenon drejtpërdrejt interesin publik dhe të drejtat tona të ligjshme.

KËRKUJME:

1. Zbatimin e menjëhershëm dhe të plotë të Vendimit nr. 1415 (80-2025-1409), datë 25.04.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në shkresën e IKMT nr. 2831/5 prot., datë 28.04.2026.
3. Bashkëpunimin institucional me Zyrën e Përmbartimit Privat "Tirana Bailiff's" për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit.
4. Heqjen e menjëhershme të bordurave prej betoni dhe çdo pengese tjetër fizike nga hapësira publike nr. 7/40, ZK 8525.
5. Lirimimin dhe sistemimin e plotë të kësaj hapësire, duke e kthyer në funksion të plotë si rrugë kalimi publike të aksesueshme për ambulancat, zjarrfikëset, Policinë e Shtetit, mjetet e furnizimit dhe shërbimeve publike.
6. Njoftimin zyrtar me shkrim të kërkuesve mbi masat konkrete të marra dhe afatin e përfundimit të ekzekutimit.

7. Marrjen e vendimit nga Bashkia Elbasan dhe Këshilli Bashkiak Elbasan për rikthimin e hapësirës publike nr. 7/40, ZK 8525, në rrugë publike me emërtimin dhe funksionin e saj sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe administrimin e territorit, duke reflektuar gjendjen faktike dhe funksionale të saj si aks kalimi publik.

Bashkangjitur ju vëmë në dispozicion një kopje të dokumentacionit të specifikuar më sipër.

Kërkuesit

Aqif Hoxha

Pellumb Acka

Ruzhdiye Zhguni

Ramazan Alla

Përparim Açka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. Regj. Them. 2366/1945/1952/823 - (00771)
Data e regjistrimit 01.07.2022

Nr. Vendimi 1415 (80-2025-1409)
Datë vendimi 25.04.2025

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

me trup gjykes të përbërë nga:

Gjyqtar: ADRIAN SHEGA

asistuar nga sekretare gjyqësore *Oriona Onuzi*, sot në datë 25.04.2025 përfundoi shqyrtimin në seancë gjyqësore me dyer të hapura të çështjes me nr. 2366/1945/1952/823 - (00771) Akti, datë regjistrimi 01.07.2022, që i përket

PADITËS:

Vejdi Hoxha, i biri i Sherif dhe Gjyle, lindur me 07.04.1962, në Qerret, Elbasan, i identifikuar me letërnjoftimin nr. G20407167C; Përqësuar në gjykim nga Av. Gramoz Lika me Licence nr. 777, Nipi nr. K31401501K Dhoma e Avokatisë Durrës dhe me prokurën e posaçme me nr. 3139 rep., nr. 1105 kol., date 27.12.2024 nga Av. Marash Logu, me adrese njoftimi: Rr. George Bush, Pallati nr. 1 (Kasmi), Kati 3, Zyra 15, Tiranë.

Palumb Aqka, i biri i Nhevalir dhe Lirij e, lindur me 17.03.1963, në Dibrë, i identifikuar me letërnjoftimin nr. G30317082O; Përqësuar në gjykim nga Av. Gramoz Lika me Licence nr. 777, Nipi nr. K31401501K Dhoma e Avokatisë Durrës dhe me prokurën e posaçme me nr. 3139 rep., nr. 1105 kol., date 27.12.2024 nga Av. Marash Logu, me adrese njoftimi: Rr. George Bush, Pallati nr. 1 (Kasmi), Kati 3, Zyra 15, Tiranë.

Pamela Shqami, e bija e Samir dhe Kujtim, lindur më 01.06.1966 në Elbasan, i identifikuar me letërnjoftimin nr. G65601609C; Përqësuar në gjykim me prokurën e posaçme me nr. 1464 rep., nr. 1105 kol., date 27.12.2024 nga Av. Marash Logu, me adrese

Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkesa e paditëseve për detyrimin e Bashkisë Elbasan për të marrë masa për lirimin dhe sisteminin e hapësirës publike të rrugës, në funksion të ambienteve të shërbimit dhe banimit të paditëseve, është e bazuar në ligj, referuar nenit 17, shkronja "ç" të ligjit nr. 49/2012, Bashkia Elbasan ka detyrimin ligjor të veprojë për rivendosjen e gjendjes së ligjshme dhe sigurimin e aksesit në pronat e paditëseve, në përmbushje të funksionit të saj si autoritet përkatës që administron hapësirat publike.

Në përfundim, bazuar në parashikimet e dispozitave ligjore të sipërcituara, si dhe dokumentacionit të administruar në dosje, objektit dhe shkakut ligjor të kërkesëpadisë dhe në analizë të provave të administruara në dosjen gjyqësore, Gjykata, çmon se, kërkesëpadia është në tërësi e mbështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet nga gjykata.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore të evidentuara gjatë gjykimit të përbëra nga: tarifa e padisë dhe shpenzimet e njoftimit të palëve në masën 3.700 lekë, bazuar në nenin 106 të K.Pr.Civile duhet të lihen në ngarkim të palëve të paditur.

Gjykata bazuar në nenet 40-41 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

1. Pranimin e kërkesëpadisë,
2. Shruqizimin e aktit administrativ kontrate për përdorim të hapësirës publike date 13.02.2019 dhe date 27.02.2024 të nxjerre nga Bashkia Elbasan.
3. Detyrimin e palës së paditur Bashkisë Elbasan liroje e sistemoje hapësirën publike të rrugës në funksion të ambienteve të shërbimit e të banimit për paditësit.
4. Shpenzimet procedurale gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

SEKRETARE
ORIONA ONLZI

CITYTAR
ADRIAN SHEGA

Date 06.07.2024

AKT-EKSPERTIMI

PERGATITUR PER; GJYKATEN ADMINISTRATIVE TE SHKALLES SE PARE
TIRANE

NR. AKTI 2366/1945/1952- (31154-00771-82-2022)

ME PALE NDERGJYQESE

PADITES: AQIF HOXHA, PELLUMB ACKA, RAMAZAN ALLA, RRUZHDIE
SHGUNI, PERPARIM ACKA

TE PADITUR; BASHKIA ELBASAN

ME OBJEKT: SHFUQIZIM AKTI

Une Dhimiter Rrumbullaku, topograf me Nr, Licence T 0523/1, NIPT L07512601G relatoj si me poshte vijon konstatimet e bera nga une ne Pasurine Nr. 7/40 ndodhur ne Lagjen "Haxhias", Zona Kadastrale 8525 Elbasan bashkerenduar me pyetjet e avokatit perkates te ceshtjes.

Pyetja Nr.1

Percaktoni kufinjte e pasurise nr. 7/40 ne terren, Zona Kadastrale 8525 Elbasan?

Bazuar ne Harten Kadastrale te kesaj pasurie bera verifikimin ne terren persa I perket kufinjeve te Pas.Nr 7/40 te cilet jane pasqyruar edhe ne Planin e Rilevimit bashkangjitur:

V-7/39 (Rruga e Spitalit)

J-9/50, 9/52, 9/269, 9/268, 9/54, 9/55, 9/56, 9/57, 9/58

L-9/47 (Rruga)

P- 7/39 (Rruga e spitalit)

Pyetja Nr.2,

Cili eshte Zeri Kadastrali Pasurise Nr. 7/40?

Zona Kadastrale 8525 ne te cilen ndodhet kjo pasuri nuk eshte azhornuar ne sistemin e ri te regjistrimit te pasurive te paluajtshme. Referuar



dokumentacionit te zyres se kadastrës Pasuria Nr. 7/40 është pasuri e llojit "Shesh" por gjate ndertimit te murit rrethues te spitalit "Xhaferr Kongoli" Elbasan I cili është pasqyruar edhe ne Planin e Rilevimit është krijuar faktikisht nje rruge kalimi per te dale ne pasurine Nr. 9/47 (rruga kryesore e spitalit) e cila nga verifikimi ne terren është e vetmja dalje qe kane banoret e pasurive te mesiperme ne Jug te Pas.Nr. 7/40.

Pyetje nr.3

A është e lire Pasuria Nr. 7/40 per funksionim normal nga pasurite e mesiperme?

Nga verifikimi ne terren dhe ne ortofoto rezulton se kjo pasuri është bllokuar nga objekti I shenuar me ngjyre te kalter ne Planin e Rilevimit bashkangjitur duke lene nje hapsire te vogel vetem per kalimin e kembesoreve duke mos lene hapsire te mjaftueshme per aksesimin me makina per furnizimin e bizneseve apo per sherbime emergjence.

Pyetja Nr.4

Ku është bazuar Bashkia Elbasan per dhenien e kesaj leje per objektin "tende per hijezim"?

Bashkia Elbasan per dhenien e kesaj leje "Tende per hijezim" është bazuar ne gjendjen juridike te pasurise nr. 7/40 marre nga Agjencia Shteterore e Kadastrës Elbasan pa bere verifikimet perkatese ne terren per te konstatuar nese cenohen ne disponimin e pasurive te tyre pale te treta.


Pyetja Nr.5

A kane dalje tjeter ose komunikim me rrugen kryesore Pasurite Nr. 9/52, 9/269, 9/54, 9/56, 9/55, 9/57, 9/58?

Objektet dhe pasurite e mesiperme aksesojne daljen kryesore vetem nepermjet Pas. Nr. 7/40 te cilen e perdorin si rruge kalimi.

Eksperti

Dhimiter Rrumbullaku



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

DATE 05/07/2024

QELLIMI Seccioni Geografiche

JA 200507
JA 200507

DVASHK/ZVASHK

516 0589 ZONA KADASTRALE 2525

NUMRI PASURISE 7.002

INDEX HARTE 22 1-2

MANAT E PASURISE Vol. 59
LOJ PASURISE Shesh

Sip.Pasuriș =


Sip. Truallit =

Sip.Ndërrësës =

NUMRI : KATEVE

NUMRI I PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:1000

Punoi

Top. Dhimitër Rexhepi

Original Filed
2/22/2007

[illegible]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRIVELIMIT URBAN

LICENCE
URBANE

MBIEMRI

EMRI

ATEBIA

DATELINDJA

VENDIMIMI

DIPLOMUAR. ME

TITULLI

Regjistruar ne Regjistrin
profesional qe nga data :

BRUMBULLAKU

DHIMITER

QAZIM

18.09.1936, Librazhd

LIBRAZHD

1976

Teknik Topograf

17.04.2017




NE PRAKTEKIM

Kat. B D

KRYETARI I KOMISIONIT

GRETA LUDJAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
"ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT TIRANA BAILIFF'S" SHPK

Nr. 281 Regj.
Nr. 720 Prot.

Tiranë më 01.07.2026

KËRKESË E PËRSËRITUR PËR EKZEKUTIM VENDIMI

DREJTUAR: BASHKISË ELBASAN

DREJTUAR: Z. Gledian Llatja
Kryetar, i Bashkisë Elbasan.

PËR DIJENI: Kreditori: Aqif Hoxha, Pëllumb Aça, Ruzhdie Shguni, Përparim Aça

Nderuar Z. Kryetar,

1. Pranë "Zyrës së Përmbarrimit Privat Tirana Bailiffs" shpk, bazuar në Vendimin Nr. 1415 (80-2025-1409) e 25.04.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar me kërkesë të palës kreditore ces përmbarrimore me numër 281 Regj. me palë:

Kreditor: Aqif Hoxha, Pëllumb Aça, Ruzhdie Shguni, Përparim Aça

Debitor: Bashkia Elbasan

Objekti: Zbatim Vendimi, Shfuqizim akti administrativ, lirim dhe sistemim të hapësirës publike

Me Vendim Nr. 1415 (80-2025-1409) datë 25.04.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatë vendosur: (i) Pranimin e kërkesëpadisë; (ii) Shfuqizimin e aktit administrativ kontratë për përdorim të hapësirës pub datë 13.02.2019 dhe datë 27.02.2024 të nxjerrë nga Bashkia Elbasan; (iii) Detyrimin e palës së paditur Bashk Elbasan të lirojë e sitemojë hapësirën publike të rrugës në funksion të ambjenteve të shërbimit e të banimit paditësit; (iv) Shpenzimet procedurale gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

2. Në zbatim të Vendimit të Gjykatës, nenin 65 e vijues të Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", në Udhëzimin e Përbashkët Nr. 30 e 30.08.2018, Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 385/7, datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor privat", të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financë Seksioni I, Pika 2, gërma "P", Organi Publik debitor që Ju drejtoni, Bashkia Elbasan detyrohet me:

3.1. Shfuqizimin e aktin administrativ kontratë për përdorim të hapësirës publike datë 13.02.2019 dhe datë 27.02.2024 nxjerrë nga Bashkia Elbasan;

3.2. Të lirojë e sitemojë hapësirën publike të rrugës në funksion të ambjenteve të shërbimit e të banimit i paditësit/kreditorët;


3.3. Pagimin e tarifës së shërbimit përmbarrimor që llogaritet në masën e një page bazë minimale mujore.

4. Bazuar në nenin 517 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafët I dhe II të tij, me shkresën nr. 514 prot. datë 04.05.2026 Lajmërim për ekzekutimin vullnetar të detyrimit Jeni lajmëruar dhe ju është kërkuar përmbushja dhe ekzekut vullnetarisht i detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv, i mësipërm, duke respektuar afatin 10 (dhjetë) ditore, që prej mar dijeni të këtij lajmërimi, në datën 07.05.2026. Dhe më pas në datën 21.05.2026 është kaluar në ekzekutim të detyruesl ne Vendimin Nr. 562 Prot. datë 21.05.2026, për të cilën Bashkia Elbasan ka konfirmuar arrijen dijeni në d: 25.05.2026.

5. Më pas në datën 29.05.2026 nga verifikimi në terren rezultoi se Bashkia Elbasan nuk ka zbatuar pikën 2 të vendimit ë liru dhe sitemuar hapësirën hapësirën publike të rrugës në funksion të ambjenteve të shërbimit e të bani për paditësit, as nuk i ka kthyer përgjigje përmbarrueses gjyqësore për planin e masave për zbatimin e vendimit ishtu nga informacioni që morem nga disa banorë të ndodhur tek objekti, po vendosnin krahe tende dhe pretendohe cishin marre leje nga Bashkia Elbasan (bashkelidhur procesverbal date 29.05.2026). Po ne datë 29.05.2026 u paraqita në Bashkinë Elbasan, ku u kërkuar marrja e masave për zbatimin e vendimit të Gjykatës Titull ekzekutiv.

6. Me shkresën 2998/1 prot. datë 02.06.2026 protokolluar me tonën me nr. 562/1 prot. datë 04.06.2026 dhe le 'Përcjellje dokumentacioni', drejtuar Inspektoriatit të Mbojtjes dhe Kontrollit të Territorit Ketu, të Bashkisë Elb:

"Zyrë e Përmbarrimit Privat Tirana Bailiffs" Sh.p.k. Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 13, Tirane, Te 355 672082134, nlaska@bailiff.al NIPT L82208022H, NR. LICENSE LN -5984-10-2018.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
"ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT TIRANA BAILIFF'S" SHPK

shpreheni se: "Bashkëlidhur kësaj shkresë do të gjeni Vendimin nr. datë 21.05.2026 Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, Vendimit Nr. 1415 (80-2025-1409) datë 25.04.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Bashkia Elbasan ka detyrimin ligjor për të ekzekutuar/zbatuar Vendimin e Gjykatës të formës së prerë, t'i dërgojë përmbarueses gjyqësore planin e masave për zbatimin e vendimit dhe jo të mjaftohet me përcjelljen e shkresave të përmbaruesit gjyqësor.

7. Kështu, moskryerja e ekzekutimit të Vendimit të Gjykatës, nga ana juaj përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike si dhe pengim në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për të cilën kam detyrën të njoftojë organet përkatëse. Dhe, referuar nenit 606 të K.Pr.Civile, ju paralajmërojmë, se në rast se, nuk kryhet veprimi i urdhëruar me shkresën Nr. 562 Prot. datë 21.05.2026 do të gjobiteni në masën 50.000 leke në cdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 66, 68 i ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", përmbaruesi gjyqësor do t'i drejtohet Gjykatës/Gjyqtarit Administrativ që ka dhënë vendimin, me propozimin për marrjen e masave të nevojshme ndaj personave përgjegjës për pengim në ekzekutimin apo moszbatimin e Vendimit të Gjykatës.

Përfundimisht kërkojmë:

(i) Bashkia Elbasan të lirojë e sitemojë hapësirën publike të rrugës në funksion të ambjenteve të shërbimit e të banimit për paditësit/kreditorët;

(ii) Bashkia Elbasan të paguajë paditësve shpenzimet gjyqësore në masën 3,700 (tre mijë e shtatëqind) lekë, pranë Raiffeisen Bank sh.a. në llogarinë përmbarimore me të dhënat "Z.P.P Tirana Bailiff's" sh.p.k., me NIPT: L82208022H me IBAN: AL54202110370000000081372717 ALL;

(iii) Bashkia Elbasan të paguajë tarifën fikse përmbarimore, në masën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë me TVSH e cila do të paguhet menjëherë së bashku me shumën e detyrimit, në numrin e llogarisë së "Z.P.P Tirana Bailiff's" sh.p.k., me NIPT: L82208022H, Nr. IBAN: AL77202110370000000001372717 Lekë.


Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,


Me respekt,

"Zyrë e Përmbarimit Privat TIRANA BAILIFF'S" sh.p.k.

PËRMBARUES GJYQËSOR

NATASHA LASKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORE PRIVATË
"ZYRËS SË PËRMBARIMIT PRIVAT TIRANA BAILIFF'S" SHPK

Nr. 281 Regj.

PROCESVERBAL

(I VEPRIMEVE PËRMBARIMORE GJATE EKZEKUTIMIT)

Sot, ne Elbasan, Viti 2026, Muaji dhjetor, Date 29.05.2026

Une, Natasha Laska me detyrë Përmbaruese Gjyqësore prane Zyrës së Përmbarimit Privat Tirana Bailiff sh.p.k. ne referim te Vendimin Nr. 1415 (80-2025-1409) datë 25.04.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Si edhe ne mbështetje te neneve 524 e vijues të Kodit te Procedures Civile, mbaj këtë procesverbal për veprimet përmbarimore gjatë ekzekutimit:

Procesverbali mbahet ne prani te

Debitorit: Dr. M. M. M.

Kreditorit: _____

dhe

Personave te trete (te pranishem):

1. Fajza J. J.
2. /
3. /

U kryen këto veprime:

Sot me date 29.05.2026, ndodhur ne Elbasan ne adresën:
dajçat Bashkia, prane spitalit Personel "Kopri Kogoni", Elbasan
sipas Vendimit nr. 1415 (80-2025-1409), dt. 25.04.2025 Tiranë
ku ishte vendosur - shfuqizimi i kontratës për përdorim të Përshtet
publike dt. 13.02.2019 dt. 27.02.2024
- Përfundim i Bashkisë Elbasan të fletës e të sistemeve ligjore publike
te mupis ne funksion te obligimit te shprehimit e te korrimit per prodhim
kon Verifikimi ne terren rezultoi se Bashkia Elbasan nuk e
te zbatuar piken e dyte te vendimit es dhe nuk i ka kthyer
te shprehur planin e masave per zbatimin e vendimit.
Kjo informacioni qe te marrim nga te bura te ndryshme,
te shprehur po vendosim krah fonde mbi korrjet dhe
nëse kjo se e te marrim nga Bashkia Elbasan kon
te shprehur informacioni qe ka korrjet qe te shprehur korrjet

PROCESVERBAL



Debitori i pranishëm pretendoi se:

Kreditore i pranishëm pretendoi se:

Personat e tretë të pranishëm pretenduan se:

Ky procesverbal, mbyllet këtu pasi lexohet, kuptohet dhe konfirmohet qartësisht dhe pa vërejtje nga të pranishmit duke u nënshkruar nga secili prej tyre. Procesverbali mbahet në disa kopje të cilat i dorëzohen të pranishmëve nënshkrues të këtij dokumenti .

NENSHKRUESIT:


Per DEBITORIN:

Zyrë e Përmbartimit Privat Tirana Bailiff s" sh.p.k.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Natasha Laska

Per KREDITORIN:



Te PRANISHËM:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 1722 Prot.

Elbasan, më: 01.07.2026.

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. Anesti Tore

Lagja "Haxhias"

Cel. 0698995888

ELBASAN

Në vijim të shkresës me Nr. 1722 Prot., datë 22.07.2026.2026, "Pezullim procedurash në Këshillin Bashkiak", Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë 11.07.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtëshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan", **pasuria me nr. 7/40 ndodhur në zk 8525 është në pronësi të Bashkisë Elbasan**.

Bashkia Elbasan bazuar në V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve", bazuar në Vendimin nr. 1415 (80-2025-1409) datë 25.04.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt "Për lirimin dhe sitemimin e plotë të hapësirës publike pasuria nr.7/40, ZK 8525, Lagja "Haxhias" me emërtimin "Lulishte" në pronësi të Bashkisë Elbasan", si dhe në kërkesën e banorëve të lagjes "Haxhias", me nr. 1529 Prot, datë 01.07.2026, me objekt "Zbatim Vendimi", ka konstatuar nevojën për rishikimin e funksionit të kësaj pasurie.

Bashkia Elbasan ka filluar procedurën për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr.7/40, ndodhur në Z.K. 8525, nga "Lulishte" në "Rrugë".

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin !

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika

KRYETARI
Gledian Llatja



823
22.07.2026
QARKUT ELBASAN



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4102/1 Prot.

Datë 22.07. 2026

VENDIM

NR. 35, DATË 22.07.2026

MBI

“TAVANET PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027-2029”

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë 22. 07. 2026, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, mbi “Miratim i tavaneve përfundimtare të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimin nr.7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”,


VENDOSI :

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2027-2029, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR
Elsid Zyma


P/ Sektor Buxhetit.: M.Behluli
Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja
D.P.Sh.M.: S. Mehmeti
D.P.K.S.A.R.S.: D.Rroseni
D.P.M.C.M.B.P: Sh. Çullhaj
Dr.Juridike: E. Arapi
Zv/kryetar : K. Krasnika

KRYETAR
Lutfi Lala



Tavanet perfundimtare te shpenzimeve per vitet 2027-2029

Nr.	Emertimi programit	Programi	Viti 2027			Viti 2028			Viti 2029		
			Shpenzime			Shpenzime			Shpenzime		
			Shpenzime personeli	te tjera korente	Shpenzim e Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	te tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Totali buxhetit
1	Menaxhimi dhe sherbimet mbeshetese	AA109	461,158	136,286	19,000	616,444	461,158	136,277	20,900	618,335	630,151
2	Rendi dhe siguria publike	AB109	111,842	107,286	44,319	263,447	111,842	110,397	48,751	270,990	279,692
3	Çeshtjet ekonomike dhe bujqesia	AC109	186,256	87,050	308,946	582,252	186,256	87,050	334,965	608,271	633,803
4	Mbrojtja e mjedisit	AD109	33,435	301,449	61,509	396,393	33,435	306,338	87,660	427,433	434,548
5	Zhvillimi urban dhe sherbimet publike	AE109	171,688	262,711	43,554	477,953	171,688	262,711	47,909	482,308	489,475
6	Argetimi, kultura dhe sportet	AF109	105,831	125,544	36,580	267,955	105,831	125,544	40,238	271,613	276,673
7	Arsimi	AG109	605,606	129,322	163,374	898,302	605,606	129,322	179,712	914,640	940,563
8	Mbrojtja sociale	AH109	199,553	77,361	75,937	352,851	199,553	77,361	83,531	360,445	370,445
9	F.Rezerve & Kontingjenca	AI109	0	30,000		30,000	0	30,000	0	30,000	36,000
Gjithsej:			1,875,369	1,257,009	753,219	3,885,597	1,875,369	1,265,000	843,666	3,984,035	4,091,350



4102/2
29.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 733/11 Prot

Elbasan, më 29.7.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.95, datë 22.07.2026 “Mbi tavanet përfundimtare të shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Ilir BEJTJA



834

22.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4095/1 Prot.

Elbasan, më 22.07 2026

VENDIM

Nr. 36 datë 22.07 2026

"Për ngritjen e një stacioni të Ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, në territorin e Bashkisë Elbasan, si dhe një shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 22.07 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Agjencia e Mbikëqyrjes dhe kontrollit "Për ngritjen e një stacioni të Ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, në territorin e Bashkisë Elbasan, si dhe një shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjin nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e stacionit të Ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, me vendndodhje Njësia Administrative Bradashesh pranë godinës së Njesisë Administrative.
2. Shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së shërbimit të MZSH, për funksionimin e stacionit të Ri zjarrfikës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit dhe Drejtoria e Shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elisat Zyme

Konceptoi:

Dr. MZSH: *E. Sota*


DSHZ: *K. Shimplaku*

Shefi parandalimit: *G. Ruda*

Pranoi:

Dr. Pergjithshem: *L. Dervishi*

Dr. JBNJ: *E. Arapi*



4095/2
28.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 834/ Prot.

Elbasan më 28.7.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.96, datë 22.07.2026, "Për ngritjen e një stacioni të ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, në territorin e Bashkisë Elbasan, si dhe një shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA

